



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

A nr. 162/13

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Nehat Idrizi kryesues, Nenad Lazić, dhe Rafet Haxhaj anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), dega në Gjakovë, paraqitur kundër subjektit politik Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës, dega në Gjakovë për shkak të vendosjes së posterëve në vende publike për Zgjedhjet Lokale, në seancën e panelit të mbajtur me 05.10.2013, mori këtë:

VENDIM

Refuzohet si e pabazuar ankesa e subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), dega në Gjakovë.

Arsyetim

PZAP-i, ka pranuar një ankesë më datë 04.10.2013, nga LDK, me të cilën pretendohet se me datën 02.10.2013 rreth orës 14:00 në rrugën “Skënderbeu” (afër pompës N. Bakia), subjekti politik AAK, ka vendosur bilbordin me mbi shkrimin Voto AAK me Anr. 62 . Parashtruesi i ankesës pretendon se është bërë shkelje e Rregullores Zgjedhore Anr. 13/2013 neni 1 dhe neni 2 pika 2.1. Parashtruesi i ankesës ka bashkangjitur fotografitë si dëshmi.

Parashtruesi i ankesës ka kërkuar që te ndërmeren masat e parapara sipas LZP.

PZAP-i, pasi që shqyrtoj gjeti se:

ankesa është e pabazuar

Pretendimet ankimore se militantët e subjektit politik AAK kanë vendosur bilbordin në rrugën “Skënderbeu”, afër pompës N. Bakia, PZAP-i, konstaton se pretendimet e ti janë te pa bazuara pasi që nga fotografitë si dëshmi te cilat gjenden ne shkresat e lendes nuk identifikohet objekti i pompës N. Bakia, për të cilin pretendohet se është

bërë shkelja e supozuar, andaj një pretendim i tillë u vlerësua si pa argumentuar dhe i pambështetur ne prova dhe dëshmi bindëse sepse nga provat e paraqitura nuk mund të shihet se në cilin objekt janë vendosur posterat në fjalë prandaj në kuptim të nenit 115.1 lidhur me 118 paragrafi 1 të LZP-së, lidhur me ankesën e lartpërmendur u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi .

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësa në Prishtinë

Anr. 162/2013 më datën 05.10.2013

Kryesuesi i Panelit
Nehat Idrizi



Udhëzim Juridik:

PZAP nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelim, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, *ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i, në rast se gjoha e përfshirë është më e lartë sesa pesëmijë (5, 000) Euro ose në rast se çështja prek një të drejtë themelore.*